



Funded by the
European Union

Capacity Building in relation to the EU Common Market Organization (CMO) Agricultural Statistics



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Kultivimi i domates



Ky grup informacioni është përgatitur për teknikët dhe kultivuesit e Kosovës nga Projekti i financuar nga BE-ja “Ngritja e kapaciteteve në lidhje me Organizimin e Tregut të Përbashkët sipas BE-së (CMO) dhe Statistikat Bujqësore”, zbatuar nga AESA, CSI Piemonte dhe FranceAgriMer, për të mbështetur kultivuesit vendas të zbatojnë standardet e marketingut për domatet dhe specin e ëmbël. Pikëpamjet e shprehura në këtë broshurë janë ato të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian, Qeverisë së Kosovës, AESA-s apo ndonjë pale tjetër të përfshirë në to. Nëse nuk specifikohet ndryshe, të gjitha fotot janë nga Dario Caccamisi.

Kultivimi i domates në mjedise të mbrojtura

Marrë në përgjithësi domatja mund të kultivohet në të gjitha llojet e mjediseve të mbrojtura, duke filluar nga tunelet e ulëta deri tek serrat më moderne.

Prodhimtaria e domates në serra, paraqet mënyrën më intensive të prodhimit të domates, me ç'rast mund të arrihen rendimente mjaft të larta e si rezultat edhe efekte të larta financiare. Në shumicën e rasteve prej sipërfaqeve të përgjithshme të serrave që shfrytëzohen për kultivimin e perimeve, në shumë vende të botës, domatja zë afër 50% të sipërfaqeve.

Për sa i përket vlerës ushqyese, rëndësisë ekonomike, përhapjes si dhe mënyrës së përdorimit, domatja është njëra ndër kulturat më të rëndësishme perimore.

Përveç rëndësisë së madhe në të ushqyerit e njeriut, domatja ka rëndësi mjaft të madhe ekonomike. Ajo është kulturë mjaft akumulative, pasi që të ardhurat për njësi të sipërfaqes janë mjaft të larta (sidomos gjatë kultivimit në serra).

Kërkesat ndaj kushteve të mjedisit

Domatja është bimë e klimës së nxehtë. Kërkesat për nxehtësi janë mjaft të theksuara dhe atë pothuajse në të gjitha fazat e rritjes dhe zhvillimit.

Temperatura minimale për mbirje është 13 – 15⁰C, ndërsa optimale rreth 25⁰C. Temperatura optimale për rritjen e organeve vegjetative është 22-24⁰C, ndërkaq për fazën e lulëzimit dhe formimit të fryteve 24-28⁰C.

Regjimi i temperaturave është i rëndësishëm në përcaktimin e prodhimit të domates. Kërkesat e bimëve për temperaturë ndryshojnë në varësi nga faza fenologjike e tyre.

Tab.1 Temperatura dhe lagështia relative e ajrit gjatë kultivimit të domates në serra

Faza e rritjes dhe e zhvillimit	Periodha kohore	Temperatura optimale (°C)		Lagështia relative e ajrit (%)
		Gjatë kohës me diell	Gjatë kohës me vranësira	
Nga ndërrimi i fidanëve deri në frutifikim	Ditën	22 - 25	18 - 20	65 – 70
	Natën	16 - 18	15- 18	
Gjatë fazës së frutifikimit	Ditën	24 – 28	20 – 22	60 - 65
	Natën	18 - 20	16 – 18	

Dëmtimi i fryteve fillon në temperaturë 6⁰C.

Përveç temperaturës së ajrit, është mjaft e rëndësishme edhe temperatura e tokës e cila preferohet që të jetë afër 20-22⁰C.

Kërkesat për dritë

Domatja bën pjesën në grupin e kulturave perimore me kërkesa më të mëdha për dritë. Kërkesat më të mëdha ka për dritë janë në fazën e fidanit, andaj gjatë kultivimit të domates në serra ku nuk mund të bëhet ndriçimi plotësues, duhet patur kujdes që kjo fazë të mos bjer në fazën e fundit të fidanit kur edhe janë kërkesat më të mëdha për dritë.

Në kushtet e dritës së pamjaftueshme, bimët e domates zgjaten, vonohet frutifikimi, frytet formohen me vështirësi etj. Andaj gjatë kultivimit të domates në serra duhet ndërmarrë të gjitha masat që e mundësojnë shfrytëzimin maksimal të dritës (pastrimi i mbulesës së serrës, distancat e përshtatshme të mbjelljes etj.). Aplikimi i ndriçimit plotësues (sidomos gjatë fazës së fidanit jep rezultate shumë të mira).

Ujitja

Gjatë ujitjes së domates në serra, duhet pasë parasysh një rregull; që bimëve t'u sigurohet sasi sa më optimale e lagështisë në tokë, por që çdo herë të kihet parasysh fakti që përmes ujitjes të mos vijë deri tek rritja e lagështisë relative të ajrit, ndaj të cilës domatja është mjaft e ndjeshme.

Sasitë e kërkuara të ujit jepen në intervale të rregullta deri në fund të vegjetacionit. Orari i aplikimit të ujitjeve duhet t'i përshtatet varësisht nga kushtet klimatike, tipi i tokës, fazës së zhvillimit dhe mënyrës së ujitjes.

Kërkesat ndaj tipit të tokës

Tokat më të përshtatshme për kultivimin e domates janë tokat e lehta dhe mesatarisht të lehta, të pasura me materie organike dhe me regjim të mirë ujorë-ajror.

Edhe pse domatja llogaritet si më tolerante ndaj reaksionit të tokës, në krahasim me disa bimë tjera perimore, megjithatë rendimentet më të mira mund të arrihen vetëm gjatë kultivimit në toka me reaksion neutral deri tek i dobët acidik (pH 5,8 – 7).

Gjatë kultivimit në serra (sikurse edhe në fushë) duhet pasur kujdes në qarkullimin bimor.

Plehërimi

Domatja ka kërkesa shumë të theksuara ndaj materieve ushqyese. Gjatë kultivimit të domates toka i nënshtrohet shfrytëzimit mjaft intensiv.

- Të ushqyerit me sasi të mjaftueshme dhe në raport të drejt në mes elementeve ushqyese, është element esencial në arritjen e rendimenteve të larta dhe me cilësi tek domatja.
- Para çdo përcaktimi të sasirave të plehrave që do të përdoren, duhet të kryhen analizat e tokës.
- Plehërimi bazë i domates bëhet me plehra organike dhe inorganike. Plehu organik ka rol të pa zëvendësueshëm në prodhimin e domates. Gjatë kultivimit në mjedise të mbrojtura duhet përdorur vetëm plehun e dekompozuar (të "djegur") në sasi 5 – 7 kg/m². Kjo sasi është e preferuar të hedhet para punimit themelor të tokës në mjedise të mbrojtura.

Tab.2. Sasitë e rekomanduara të materieve ushqyese

Niveli i pjellorisë në tokë	Sasitë e rekomanduara kg lëndë aktive / 100 m ²			
	N	P	K	Mg
I ulët	3.5	2.5	5.5	2.8
Mesatar	2.8	1.5	4.4	2.0
I lartë	2.0	0.5	3.2	1.2
Shumë i lartë	1.2	0	1.9	0.4

Kultivimi i domates

Afatet e prodhimit të domates në serra varen nga:

- lloji i objektit (mundësia e ngrohjes),
- kërkesat specifike të tregut dhe
- vetitë biologjike të domates (dhe kultivarit).

Gjatë planifikimit të prodhimit të domates, duhet patur parasysh faktin se nga mbirja deri në fazën e lulëzimit kalojnë 55-75 ditë (varësisht nga kultivari dhe kushtet e kultivimit).

Në përgjithësi mund të thuhet se prodhimtaria e domates në serra mund të organizohet në atë mënyrë që të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm i tregut me fruta të freskëta të domates gjatë gjithë vitit.

Tab.2 Afatet e mundshme të prodhimit të domates në serra

Lloji i objektit (serrës)	Periudha kohore	Mbjellja e farës	Ndërrimi i fidanëve	Fillimi i vjeljes
Serra me ngrohje	Vjeshtore	15-30.VII	5 – 15.IX	1 – 15.XI.
	Dimërore	10.IX–5.X.	15.XI.– 15.XII.	10.I.– 20.II.
	Pranverore	20.XI– 15.XII.	25.I. – 20.II.	25.III.– 15.IV
Serra pa ngrohje	Pranverore	25.I.–15.II.	25.III.–10.IV	10-20 .VI.
	Verore	1-15.III.	25.IV – 5 .V.	25.VI – 15.VII.
	Vjeshtore	10-20 V.	20.VI.-5.VII.	12.IX.- 15.X.

Përgatitja e fidanit

Përgatitja e fidanit të domates mund të bëhet në forma të ndryshme. Zakonisht aplikohen masat standarde të prodhimit të fidanit në kushte bashkëkohore (më detalisht shih kaptinën për prodhimin e fidanit)

Pa marrë para sysh ambientin në të cilin kultivohet, përgatitja e fidanit është njëra nga hallakat më të rëndësishme të prodhimit të domates.

Zgjedhja e farës cilësore dhe kultivarit të përshtatshëm, gjithashtu janë parakushte shumë të rëndësishme për prodhim të suksesshëm të domates, përveç tjerash edhe nga fakti se gabimet eventuale, në këtë fazë nuk mund të përmirësohen në fazat e mëvonshme. Fara e cila përdoret për mbjellje tek domatja, duhet të ketë cilësi të mirë, e dezinfektuar, përkatësisht të jetë e shëndoshë.

Përgatitja e tokës për ndërrimin e fidanëve, varet nga koha e ndërrimit dhe parakultura. Përgatitja duhet të jetë sa më cilësore. Para dhe gjatë përgatitjes së tokës bëhet edhe plehërimi themelor.

Përgatitja përfundimtare rëndomtë, nënkupton përgatitjen e vllajave, që krijojnë kushte më të favorshme për kultivimin e bimëve. Nëpërmes punimit të tokës duhet krijuar reshim të mirë ujqorë-ajror, që është kusht shumë i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin e mirë të domates.

Gjatë kultivimit të domates në serra në shumicën e rasteve kultivimi bëhet me mulçirim. Përmes kësaj mase bëhet mbulimi i sipërfaqes në mes të rendeve me folie plastike, kryesisht me ngjyrë të zezë. Në prodhimin bashkëkohor në masë të madhe përdoren folie që nga ana e poshtme janë me ngjyrë të zezë kurse nga ana e epërme me ngjyrë të bardhë. Përmes aplikimit të aplikimit të kësaj mase, arrihen disa efekte pozitive. Arrihet racionalizim i punëve (nuk ka nevojë për prashitjet në mes rendeve, nuk ka rritje të barojave, shfrytëzimi i ujit është më racional, toka është më e nxehtë, rritja e bimëve më intensive dhe të gjitha këto ndikojnë në rritjen e rendimentit të përgjithshëm.

Ndërrimi i fidanëve

Gjatë kultivimit në lloje të ndryshme të serrave distancat e mbjelljes varen edhe nga prodhimi i parashikuar dhe periudha kohore e planifikuar për shfrytëzim. Në bazë të këtyre parametrave numri i bimëve për 1 m² lëviz nga 2 – 4.

Masat e përkujdesit gjatë vegjetacionit

Domatja gjatë gjithë vegjetacionit kërkon kujdes mjaft intensiv. Përveç masave të zakonshme të përkujdesit (ujitja, plehërimi, mbrojtja nga sëmundjet dhe dëmtuesit, etj), tek domatja ndërmerren edhe disa masa **specifike** (sigurimi mbështetësve, largimi i sqetullorëve etj).

Gjatë kultivimit në lloje të ndryshme të serrave aplikohen edhe disa masa tjera që dallojnë nga kultivimi në fushë të hapur si mbajtjen e temperaturës optimale, lagështisë optimale të ajrit, ndriçimi plotësues, rritja e përqendrimit të CO₂, ajrosja e serrave etj.

Ujitja

Numri i ujitjeve varet nga, tipi i tokës, temperaturat e ambientit të jashtëm, faza e rritjes dhe zhvillimit të bimëve, etj. Ujitja mund të bëhet në forma të ndryshme. Në prodhimtarinë intensive të domates aplikohet pothuajse në tersi ujitja përmes sistemit pikë-pikë. Kjo formë e ujitjes ka përparësi të mëdha në krahasim me ujitjen me brazda dhe ujitjen në formë të shiut. Në fazat e hershme ujitjet duhet të jenë më të rralla, ndërsa me fillimin e fazës së lulëzimit dhe frytifikimit, ujitjet duhet të jenë më të shpeshta. Kjo ndodhë për arsye se përveç rritjes së kërkesës së bimëve për lagështi në këtë fazë, zakonisht vie edhe tek ngritja e temperaturave.

Riplehrimi

Riplehrimi i bimëve të domates fillon 10 – 15 dit pas ndërrimit. Mandej riplehrimet vazhdojnë në fazën e lulëzimit dhe formimit të fryteve. Gjithashtu është e preferuar që pas çdo vjelje të bëhet një riplehrim.


Gjatë kultivimit në lloje të ndryshme të serrave dhe përdorimi i sistemit të ujitjes pikë-pikë, riplehrimi i bimëve bëhet kryesisht përmes këtij sistemi, duke bërë shpërndarjen e plehrave bashkë me ujin i cili përdoret për ujitje. Në këtë rast është e mundur që të kontrollohet sasia totale e plehut të përdorur. Sasitë e rekomanduara me këtë metodë janë 2-5 kg/ha/ditë në 2-3 javët e para pas trapiantimit të bimëve dhe 10-20 kg/ha/ditë në fazën e rritjes intensive dhe të frutifikimit. Përqendrimet e rekomanduara të plehrave me këtë metodë janë 0.1-0.2 gr/litër në javët e para pas trapiantimit dhe 0.3-0.5 gr/litër gjatë fazave të mëvonshme. Nëse plehërimi aplikohet një herë në 2 ose 3 ujitje, përqendrimi i plehrave rritet në të njëjtën masë, por duke i kushtuar vazhdimisht vëmendje shmangies së fenomeneve të kripëzimit në tokë. Gjatë gjithë kësaj kohe duhet patur kujdes në raportin optimal në mes të elementeve bazë (N, P, K), në përputhje me kërkesat e domates në faza të ndryshme të rritjes dhe zhvillimit.

Largimi i sqetullorëve është masë e rregullt gjatë kultivimit të kultivarëve indeteminant. Largimi i tyre bëhet në mënyrë të vazhdueshme, kur ato arrijnë gjatësi 4 – 5 cm. Ato mund të largohen në forma të ndryshme por duhet patur kujdes që gjatë largimit të tyre mos të dëmtohen pjesët tjera të bimës. Edhe sigurimi i mbështetsëve është masë e domosdoshme tek këta kultivar. Mbështetëset mund të jenë të formave të ndryshme. Tek domatja sidomos në fazën e fundit të vegjetacionit aplikohet **largimi i gjetheve të vjetra** të cilt fillojnë të marin ngjyrë të verdhë.

Vjelja

Koha e pjekjes së fryteve të domates varet nga disa faktor: kultivari, kushtet klimatike (në rend të parë temperatura dhe ndriçimi), pozicioni i frytit në lulëri etj. Rritja e temperaturës (brenda kufijve optimal) shpejton pjekjen.


Six Ripening Stages of Tomatoes



Indekset e pjekurisë së domateve

Frutat e domates vilen në fazën e nevojshme të pjekjes për marketing ose konsumim.

Zakonisht, domatet vilen në fazën e thyerjes së ngjyrës për tregjet e largëta dhe në fazën plotësisht të kuqe/pjekur për tregjet lokale.



Source: Tomato Dirt.

Pjekuria e duhur për vjeljen e domateve

Domatet e papjekura nuk piqen pas vjeljes. Faza aktuale në të cilën ato duhet të zgjidhen varet nga preferencat dhe zakonet lokale në çdo vend.

Domatet përparojnë nga plotësisht jeshile në fazën e parë të pjekurisë në më shumë se 90% të sipërfaqes së domates duke qenë e kuqe në fazën e gjashtë dhe të fundit të pjekurisë.

Nëse domatet do të përdoren në gjendje të pjekur, ato duhet të mblidhen sa më shpejt që të jenë të paktën thyerëse. Vjelja e domates fillon në fazën e dytë kur ka një thyerje të ngjyrës nga jeshile në të verdhë të nxirë duke mbuluar më pak se 10% të sipërfaqes së domates.


THYES: Domatet kanë arritur gjendjen e gjelbër të pjekur kur janë plotësisht të rrumbullakosura dhe kanë ndryshuar nga jeshile e errët në mesatare ose e lehtë, dhe lëkura zhvillon një shkëlqim dylli.

KTHESIMI: Me fillimin e pjekjes, fruti shfaq një nuancë rozë të zbehtë ose të verdhë, e cila zhvillohet përmes një rozë të caktuar në të kuqe të plotë.

ROZË: Shumica e domateve mblidhen në fazën e hershme të pjekjes ose ngjyrës rozë, në varësi të preferencës së tregut dhe kohës që duhet për të arritur tek shitësi.

E KUQE E LEHTË në **E KUQE PJEKUR:** Domatet që do të konsumohen menjëherë mund të korren kur të jenë plotësisht të pjekura.


Domatet për tharje duhet të korren në fazën e gjashtë dhe të fundit kur mbi 90% e sipërfaqes është e kuqe.



Vjelja e domateve

Pesha, madhësia dhe Brix rriten gjatë gjithë procesit të pjekjes, ndërsa qëndrueshmëria zvogëlohet.

Meqenëse të gjitha frutat nuk piqen në të njëjtën kohë, ato vjelen në një interval prej 3-4 ditësh. Në përgjithësi, do të ketë 7-11 vjelje në jetëgjatësinë e një kulture.



Kërcellët e frutave të domates kanë një pikë thyerjeje natyrale. Fruti i pjekur shkëputet lehtësisht nga grupi kur ushtrohet presion në këtë pikë ndërsa ngrihet fruti lart.

Domatet mblidhen (vjelen) kur fruti më pak i pjekur në degë fillon të tregojë ngjyrë të kuqe. Kjo siguron uniformitet kur produkti arrin te konsumatori.

Domatet mblidhen më së miri në kova (kova) plastike dhe transferohen nëse është e nevojshme në arka plastike që mbajnë në mënyrë ideale deri në 10 kg, jo më shumë se 20 deri në 25 kg peshë.

Llojet e domateve	°Brix
Tomatina	6.0 — 10.0
Domate	3.5 — 5.5

Mënyra e vjeljes së domateve

Vjelja manuale duke përdredhur frutat me gishtin e madh.

Shmangni çdo dëmtim të frutave.


Vjelja duhet të bëhet ose në orët e hershme të mëngjesit ose në orët e mbrëmjes.

Prodhimet e vjelura duhet të ruhen në një vend të freskët.

Idealisht para-ftohja përpara se të renditet ose klasifikohet.

Fortësia e domates varet nga ngurtësia e epikarpit, konsistenca e pulpës, proporcioni i indit lokal (strukturat xhelatinoze) dhe perikarpi. Domatet më të forta janë përgjithësisht më pak të prirura ndaj dëmtimeve fizike ose strukturore dhe kanë një afat më të gjatë ruajtjeje. Nivelet e larta të kalciumit në murin qelizor do të përmirësojnë qëndrueshmërinë e frutave dhe, rrjedhimisht, karakteristikat e transportit dhe ruajtjes. Prandaj, plehërimi me kalcium ka një rëndësi të madhe për kultivimin e domates.

Pjekja e domateve



Pjekuria fiziologjike është faza e zhvillimit kur tek domatet ka ndodhur rritja dhe maturimi maksimal.

- Pjekuria tregtare e domates është faza e zhvillimit që kërkon tregu.

Pjekuria e vjeljes, e cila mund të përkufizohet në termat e pjekurisë komerciale, është kur fruti, ose organi tjetër ekonomikisht i rëndësishëm i rendimentit, ka arritur një gjendje "pjekjeje" dhe mund të hiqet nga bima (i vjelur). Pjekuria në vjelje ndikon në tregtueshmërinë dhe jetën e ruajtjes së

domates, përmbajtjen ushqyese, freskinë dhe shijen.

Kërkesat tregtare në standardin e tregut të domates

Kërkesat minimale: domatet duhet të jenë të shëndosha; Përrjashtohet prodhimi i prekur nga kalbja ose përkeqësimi që e bën atë të papërshtatshëm për konsum.

Mund të lejohen mavijosje shumë të lehta (klasa I) ose defekte ose mavijosje të lëkurës, me kusht që fruti të mos jetë i prekur seriozisht (Klasa II).

Mund të lejohen defekte të lehta në ngjyrosje (Klasa I) ose defekte në ngjyrosje (Klasa II).

<https://ofags.com/ripening-stages-of-tomatoes/>

Punët e rrezikshme të Fëmijëve në Perimtari:

Te nderuar fermer, kultivues të perimeve, MBPZHR konkretisht Departamenti i Shërbimeve Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ka marr për sipër ndërgjegjësimin e fermerëve për punët e rrezikshme në Bujqësi, në rastin konkret në kultivimin e perimeve.

Krahas këshillave teknike për prodhimtarin e caktuar po ju bashkangjesim në këtë broshurë edhe tabelën me **aktivitetet** që janë të rrezikshme për fëmijë, **rreziku** dhe **efektet ose pasojat** që mund të kenë fëmijët tuaj nëse angazhohen në punë të tilla.

Aktivitetet që kërkojnë kujdes të shtuar të fermerëve në kuadër të perimekulturës janë listuar në tabelën vijuese.

Aktiviteti	Rreziku	Efektet në shëndetin e fëmijëve
Përgatitja e tokës për mbjellje	Përdorimi i makinave të rënda. Orari i gjatë. Ekspozimi ndaj zhurmës.	Lëndimet me makina, deri në fatalitet, nga aksidentet potenciale. Lodhje e madhe dhe deformime trupore. Dobësim i dëgjimit.
Masat e përkujdesit gjatë vegjetacionit.	Orari i gjatë në fushë. Përdorimi i mjeteve të ndryshme të punës për këto masa të përkujdesit.	Dëmtime të ndryshme si rezultat i ekspozimit për kohë të gjatë kushteve të pa favorshme klimatike (temperaturave të larta, ftohtit). Lëndime të ndryshme nga mjetet e punës dhe operimi me makina (p.sh. motokultivatori).
Puna me pesticide (përfshirë trajtimin e farës)	Ekspozimi ndaj pesticideve dhe mjeteve tjera toksike.	Helmimet akute me pesticide (edhe me materie që përmbajnë plehrat minerale). Efektet afatgjate në shëndetin e fëmijëve (problemet respiratore, neurologjike deri te kancerogjene).
Plehërimi	Bartja e peshave të rënda. Orari i gjatë. Ekspozimi ndaj materieve toksike që përmbajnë plehrat e ndryshëm.	Lodhja dhe dhimbjet e nyjeve dhe muskujve. Deformimet trupore. Helmimet akute nga materiet toksike të plehrave. Efektet afatgjate të materieve toksike në shëndetin e fëmijëve (problemet respiratorë, neurologjike deri te kancerogjene).
Puna në serra	Temperaturat e larta Mbetjet e pesticideve Gazrat helmuese	Dehidratimi dhe lodhja e madhe, alivanosja. Dëmtimet e organeve respiratore. Helmimet nga mbetjet e pesticideve

		dhe gazrave tjerë në serrë (sidomos kur nuk janë të ajrosura mirë).
Ndërrimi i fidanëve të perimeve	Orari i gjatë i punës. Qëndrimi i trupit për kohë të gjatë në pozitë të pa favorshme për fëmijët.	Dëmtime të muskujve të këmbëve. Lodhje e madhe. Dëmtim i frymëmarrjes për shkak të kushteve të pa favorshme në serra.

Kujdes!

Fermerët duhet të marrin masa që fëmijët mos të jenë prezent dhe të mos përfshihen në asnjë fazë të përgatitjes, aplikimit apo ruajtjes së pesticideve.

Te kuptuarit e punës se fëmijëve

Ky mesazh nuk ka për qëllim ndalimin rigoroz të punëve, por ka rol të ndërgjegjësimit të fermerëve dhe bizneseve për rreziqet që paraqesin disa nga punët në bujqësi.

Jo të gjitha punët që kryejnë fëmijët dhe adoleshentët duhen të klasifikohen si punë të rrezikshme të fëmijëve dhe duhet të eliminohen. Pjesëmarrja e fëmijëve ose e adoleshentëve në punë që nuk ndikon në shëndetin dhe zhvillimin e tyre personal, ose që nuk ndërhyjnë në shkollimin e tyre, në përgjithësi konsiderohet si pozitive. Kjo përfshin aktivitete të tilla si të ndihmshëm prindërit rreth shtëpisë, të ndihmshëm në një biznes familjar ose të fitosh para jashtë orëve të mësimi dhe gjatë pushimeve shkollore.